



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga Arifon Te
10. Shkollë Bashkë dhe mban nga dërguesi nr 01
datë 03.05.2024 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot. 180
22.05.2024

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z KRYETARIT TË BASHKISË
-Znj/Z Por dyerit, 2. RAHM SPAHIU
-Znj/Z Kostellit Bashkë Dibër

me porosinë:

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të pë
do të jetë

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 22.05.2024

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK
Anëtarët e Këshillit Bashkiak

REZOLUTË

Nr. 01, Dt. 03.05.2024

PARAQITUR DHE MIRATUAR NGA ANËTARËT E KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

Ne mbledhjen e dt. 03.05.2024, ne mbeshtetje te inisiatives se nje grupi keshilltaresh anetare te Keshillit Bashkiak te Bashkise Diber te materializuar me kerkesen e depozituar me pare ne Bashkine Diber me nr.1508 prot. dt.22.04.2024, procedure kjo e parashikuar nga Ligji Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Neni 53, Pika 3, germa "b" (Funksionimi i keshillit bashkiak); ne permbushje te Misionit te tije te parashikuar nga Neni 3 i ketije Ligji si dhe bazuar kompetencat e tije te parashikuara ne piken "k" te Nenit 54 "Detyrat dhe kompetencat e keshillit bashkiak" te Ligjit Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ; u trajtua kjo Kerkese dhe ne mbeshtetje te sajë dhe argumentave shoqeruese, si dhe ne mbeshtetje te draft Rezolutes se propozuar, ne anëtarët e Këshillit Bashkiak te Bashkise Diber, miratojme qendrimin tone ne forme Rezolute me pikat e me poshtme :

- Ne besojme se projekti i hidrocentralit te Skavices (HEC Skavica) shkakton pasoja te pariparueshme social mjedisore, nderkohe qe ky projekt, nuk sherben per te zgjidhur problemin e sektorit te energjise elektrike, por vetem thekson mbivaresine ne burime hidrike,

- Ne rrethanat kur nuk jane duke u shfrytezuar burime alternative per prodhimin e energjise nga teknologjia fotovoltaike dhe eolike, ku Shqiperia ka nje potencial te jashtezakonshem, akoma te pashfrytezuar¹,

- Ku ne vete territorin e Dibres, ne toka me pronesi shteterore, mund te ndertohen sisteme fotovoltaike ne rreth 877 hektare toke, posacerisht ne Gjarice, Moranice, Thekanush, Shumbat dhe Pasmarr,

- Dhe bazuar ne faktin se keto projekte e largojne mbivaresine e sektorit nga burimet hidrike te cilat ndikohen nga ndryshimet klimatike dhe gjithashtu, nuk sjellin kosto sociale pasi bazohen ne lirine kontraktuale mes paleve, duke iu nenshtuar legjislacionit perkates,

¹ https://unece.org/sites/default/files/2021-07/UNECE-RE_Uptake_Factsheet_Albania.pdf, faqe 1

[Handwritten signatures and initials]

• Ne kushtet kur dëmi i parashikuar nga ndërtimi i hidrocentrali i Skavicës, nuk mund të rikuperohet, pasi, në përfundim të ciklit të jetës së diges (sipas literatures parashikohet rreth 100 vite), zona që hidrocentrali ka përmbytur do të kthehet në një zonë, jo vetëm të pashfrytëzueshme nga aspekti energjistik, por e pa-rikuperueshme dhe nga aspekti mjedisor.

• Kur në raportin e fundit të KLSH² për performancën e shoqërive publike në sektorin energjetic në administrimin e rezervës hidrike në kaskaden e Lumit Drin, për periudhën 2021/2022, konstatohet që KLSH nxjerr si përfundim se mbështetja në hidrocentrale është jo efiçente dhe rekomandohet kalimi në burime alternative si me sipër, si dhe vihet në dukje se niveli i humbjeve në rrjet është i lartë (21-20%), nivel që do të mjaftonte për të kursyer energji sa prodhimi i me shumë se një HEC Skavice, nëse do të ishte në operim,

~~• Kur edhe AKBN, në raportin vjetor³ 2021, thekson varësinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shkak se ky prodhim bazohet kryesisht në burime hidrike dhe kjo e bën të nevojshëm diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë~~

• Duke marrë parasysh ndikimet e medha sociale, ku sipas informacionit të marrë nga Bashkia Diber⁴ si dhe në raportin e publikuar nga KESH⁵ si zhvillues i këtij projekti (Nderveprimi për Mjedisin, raporti Teknik), preken në Kukës tre fshatra ndërsa në Diber, nga totali i 15 njësive administrative të kësaj bashkie, përmbysen 10 njësi administrative me 36 fshatra, një me shumë se ato që gjenden në të dhënat e Bashkisë. Konkretisht, sipas KESH dhe Bashkisë, njësitet administrative që përmbysen janë Zall Rec, Zall Dardhe, Slove, Fushe-Cidhen, Arras, Kastriot, Muhurr, Luzni, Tomini, Maqellare. Sipas këtyre të dhënave zyrtare, përmbysen me mijëra hektare toke dhe bahesa, dhe me mijëra banorë detyrohen të shpërngulen,

• Duke konsideruar që lumi i Drinit të Zi në territorin e Dibres është i vetmi segment i këtij lumi që rrjedh lirshëm, pa dige, pellgu ujembledhës i të cilit përben bazën e një ekosistemi mijeravjeçar⁶, dhe që në lashtësi, lugina e Drinit të Zi shërben jo vetëm si vend tërheqës për të jetuar, por edhe si një arterie natyrore që lidh Shqipërinë Verilindore me Maqedoninë Perëndimore, Kosovën dhe viset e tjera fqinje dhe me të largëta,

• Bazuar në ndikimet e parashikura mjedisore, të vëna në dukje në rezolutën e Konventës së Bernës në mbledhjen e saj të Marsit 2024^{7,8}, siç janë rreziku ndaj

² <https://panel.klsh.org.al/storage/phpXHWktB.pdf>, faqe 23

³ <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2014/06/Bilanci-Komb%C3%ABtar-i-Energjis%C3%AB-2021.pdf>, faqe 18

⁴ https://bankwatch.org/wp-content/uploads/2022/07/Diber-Municipality-10-June-2022_document.pdf

⁵ <https://www.kesh.al/wp-content/uploads/2023/02/Projekti-Hidroenergjetik-i-Skavices-Vleresimi-i-Ndikimit-Ne-Mjedis-Dhe-Social-Nderveprimi-Me-Mjedisin.pdf>

⁶ <https://stopskavica.org/2022/03/08/argumentat-kunder-ndertimit-te-skavices/>

⁷ <https://www.monitor.al/konventa-e-bernes-do-te-monitoroie-projektin-e-skavices-per-shkelje-te-mundshme-shprese-per-lumin-e-drinit-te-zi-dhe-speciet-e-rrezikuara/>

⁸ <https://www.coe.int/en/web/bern-convention/-/alleged-habitat-destruction-due-to-the-construction-of-the-skavica-hydropower-plant-on-the-drin-river>

[Handwritten signatures and initials at the bottom of the page, including names like 'Dibër', '1/10', and various illegible signatures.]

rreqebullit ballkanik, specie rreptesisht e mbrojtur, si dhe shume habitateve dhe specieve te tjera qe gezojne mbrojtjen e kesaj konvente te ratifikuar ne ligj⁹ ne Shqiperi, rreziku ndaj Lumit te Drinit te Zi si nje zone e propozuar Zmerald¹⁰, duke mos harruar ndikimet ne liqenet e Ohrit dhe te Shkodres si dhe te mishngrenesve te medhenj,

- Duke u nisur nga thirrja e Konventes se Bernes ne kete mbledhje qe Shqiperia te zbatoje parimin e parandalimit duke mos vene ne zbatim projekte me ndikim ne zonen e kesaj Konvente brenda dhe jashte Shqiperise

- Duke marre parasysh rezoluten e Parlamentit European, me date 12 Korrik 2023¹¹ qe ben thirrje per permiresim te transparencës, sjelljes, zbatimit dhe monitorimit te vleresimit te ndikimit mjedisor dhe strategjik ne mjedis, veçanerisht ne projekte me pasoja te medha mjedisore dhe socio-ekonomike, siç është projekti i hidrocentralit Skavica; shpreh shqetesimin e saj per çështjet ekonomike dhe mjedisore nga ndikimi i projekteve zhvillimore jokonkurruese te financuara nga jashtë;

- Duke u mbeshtetur ne gjetjet e Raport Progresit te Komisionit European per vitet 2022/2023^{12,13}, ku per HEC Skavicen, konstatohet se ka nje ndikim te madh social mjedisor, ndikon korridoret migratore te rreqebullit ballkanik, ka shqetesime serioze nga komuniteti dhe shoqeria civile per mos konsultim si per vendim marrjet ne lidhje me te ashtu dhe per planin e zhvendosjes, si dhe u kerkon autoriteteve per te zbatuar legjislacionin ne fuqi dhe paken ligjore per Komunitetin e Energjise; sidomos sa l perket konsultimeve, cilesise se Vleresimit te Ndikimit Social Mjedisor e te tjera,

- Duke konstatuar qendrimet publike te Bankes Boterore, shprehur ne intervisten e Kryesuesit te Zyres ne Shqiperi, Z. Emanuel Salinas¹⁴, dhene per A2News, me date 28.10.2022, ku thekson se duhet te punojme te diversifikojmë gjenerimin e energjise përmes burimeve të rinovueshme, të gjelbra.

- Gjithashtu edhe se ne raportin e Tranzicionit te Bankes Europiane per Rindërtim dhe Zhvillim, (BERZH) publikuar ne 2022¹⁵, theksohet se Këshillat për qeverinë drejtohen tek diversifikimi i energjise së rinovueshme dhe se në këtë drejtim duhet të avancohet me shpejt në projektet e energjise diellore dhe të erës

⁹ <https://sane27.com/wp-content/uploads/Law-no.8294-of-02.03.1998.pdf>

¹⁰ https://bankwatch.org/press_release/western-balkans-scientists-and-ngo-representatives-call-for-more-rivers-to-be-protected-as-part-of-the-emerald-network?fbclid=IwAR2umY2vt50vOKQ7W8ytVMQqWHRhEA3TghkaRwODdN2oDh3IGq6Hy9vEvc

¹¹ https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-9-2023-0285_EN.html, pika 82

¹² <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>

¹³ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

¹⁴ <https://a2news.com/2022/10/28/drejtuesi-i-bankes-boterore-shqiperia-te-krijojte-rezerva-per-te-perballuar-krizat-e-ardhshme/>

¹⁵ <https://www.monitor.al/berzh-koncesionet-ppp-dhe-garancite-per-kesh-dhe-oshee-cenojne-stabilitetin-fiskal/>

The bottom of the page contains several handwritten signatures and initials in black ink. From left to right, there are approximately seven distinct signatures, some appearing to be official or formal, and others more casual. The signatures are written over the bottom portion of the page, partially overlapping the footer area.

• Duke marrë parasysh se në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Diber, miratuar nga Kryeministri, Z. Edi Rama¹⁶, me datë 14.04.2017 si dhe Planin e Rishikuar të miratuar¹⁷ me datë 09.11.2022, nuk ka asnjë planifikim për projektin HEC Skavica, me ndikim në territorin e Dibres,

• Duke u bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese me numër 3/2024¹⁸, e cila e gjeti ligjin me numër 38/2021 për HEC Skavicën në shkelje të nenit 56 të Kushtetutës dhe urdheroi autoritetet të garantojnë të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të këtij ligji, si dhe marrjen parasysh të rezultateve të procesit të informimit të publikut në zbatim të nenit 8 të Konvetes së Arhusit,

• Konstatimit që procesi i informimit të publikut vijon të jetë me mangësi,

• Bazuar në perfundimin e studimit të Sogreas të vitit 2009 e cila e cilesonte digën në nivelin 441¹⁹ metra mbi nivelin e detit si jo të financueshem për shkak të ndikimeve të mëdha sociale mjedisore, qasje e cila u miratua dhe nga qeveria e drejtuar nga Z. Edi Rama, në vitin 2016, bere e ditur nga ish Ministri i Infrastruktura dhe Energjisë, Z. Damian Gjijnuri, publikisht,

• Konstatohet se projekti aktual ka një nga alternativat me të preferuara, kuotën përmblytje në nivelin e 442 metra mbi nivelin e detit, përkundrazi nga sa me siper,

• Duke u nisur nga fakti se në zonën e Skavices, ku propozohet të ndërtohet diga, gjeologjia përbehet nga shkëmbinj dhe gropa karstike,

• Dhe nga fakti se zona është historikisht me sizmicitet të lartë, duke përbeur një rrezik të shtuar për zonën poshtë digës,

• Duke u bazuar në faktin që bashkia Diber, me këtë projekt, copezohet dhe behet jo funksionale, ku 10 nga 15 njësi administrative (si me lart) përmblyten në permasa të ndryshme,

• Por edhe që fshatrat që mbeten²⁰, behen jo funksionale, me krijimin e liqenit artificial dhe humbjen e lidhjes me pjesën e territorit të përmblytur,

• Duke konstatuar një reagim të gjërë popullor kundër këtij projekti në zonën e Dibres dhe jo vetëm, pa dallime partiake, shfaqur në protesta si në Diber, në Tiranë dhe në diasporë, në letra, kërkesa, peticione, tryeza të rrumbullaketa etj,


¹⁶ <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dumpFile&t=f&f=2220&token=715c74d27f351dd2bd07e01851faf2eeb868ed0c>

¹⁷ <http://dibra.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Dokumenti-i-Rishikimit-t%C3%AB-PPV-Dib%C3%ABr.pdf>

¹⁸ https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

¹⁹ https://www.youtube.com/watch?v=a0_Nvj3bNTw

²⁰ <https://stopskavica.org/2022/03/06/skavica-me-mire-nie-diber-pa-hidrocentral-apo-nie-shqipëri-pa-diber/>



• Duke marrë parasysh faktin se Shqipëria, ashtu si dhe çdo vend tjetër, duhet të konsiderojë vlerën e lartë të ruajtjes së sipërfaqes së tokës dhe burimeve nënujore, të cilat HEC Skavica do të shkaterrojë, dhe për faktin se ky projekt prek afërsisht 100 km² tokë produktive, kur dihet se lugina e Drinit të Zi, me tokën pjellore, ka shërbyer si një hambar jo vetëm për të, por edhe zonat përreth,

• Kur ne mendojmë se përmbytja e një pjese të rëndësishme të Dibres, do të çojë në shkatërrimin e kujtesës historike, kur dihet se Dibra ka luajtur një rol të rëndësishëm në çdo etapë të historisë kombëtare (duke kulmuar me periudhën e luftërave të Skënderbeut dhe duke vijuar me tej jo vetëm në mbrotje të vetes por edhe krahinave të tjera shqiptare, që nga Shkodra, në Kosovë e kudo),

• Kur shqetësuese mbetet ndikimi i HEC Skavices në kulturen e një qyteterimi mijeravjeçar në vazhdimësi në këto lugine, me vlerat materiale dhe shpirtërore të banorëve, që i kanë të lidhura me token, shtëpinë, krahinën, kengët e vallet, veshjet, me të shkuarën e fisit, fshatit, krahinës, varret e të parëve etj.

• Kur ne mendojmë se investimet e qeverisë Shqiptare për ndërtimin e rruges së Arbrit duhet të shërbejnë Dibres për ta kthyer luginën e Drinit të Zi në një nga destinacionet më të afërta të turizmit për kryeqytetin dhe jo vetëm, duke qenë se Dibra do të afrohet jo më shumë se 70 km ose 45 minuta rrugetim,

• Si dhe në investime përgjatë luginës së Drinit të Zi, të 70 km lumë i eger dhe pa nderhyrje,

• Për shkak se Dibra ka një potencial të jashtëzakonshëm të turizmit për këter stinët, jo vetëm për mjedisin dhe biodiversitetin e lakmuar, por edhe për shkak të karakteristikave sociale kulturore për kombin shqiptar,

• Kur Dibra është rajoni më i pa eksploruar në pikepamje arkeologjike, ku janë evidentuar gjurmët më të hershme të qyteterimit neolitik në Shqipëri si dhe vendbanime prehistorike^{21,22}, ndër të tjera njohja me qendra të njohura historike në rajonin e Dibres së Vogel (si në Gjorice etj) dhe asaj të Madhe, në bashkëveprim, do të ishte një zhvillim i mirepritur

• Në kushtet kur ne mendojmë se hidrocentrali i Spilese i ndërtuar në Dibren e Madhe në 1968 (fusha e Udovës) solli

²¹ <https://stopskavica.org/2022/03/08/argumentat-kunder-ndertimit-te-skavices/>

²² Rrezikohen të përmbiyten 1-Zona Tumulare e Draj-Recit dhe të Zall-Dardhes, të periudhës së Hekurit, 2-vendbanimi eneolitik në Zall Sine (kodra e qytetit), 3-vendbanimi i neolitit të hershëm Kroneza (Fushe-Allije), 4- Stacioni Rrugor romak në Xhuret e Përnezheve (Fushe-Allije), 5-vendbanimi pre-historik në Rrokocel të Kutes (Fushe-Allije/Bllice), 6-vendbanim pre-historik në Kodra e Ferres (Fushe-Allije/Bllice), 7-Kodra e Pareve (Fushe-Allije/Bllice), 8-vendbanim pre-historik në Cetushë, 9-Kodra e Balles (Muhurr), 10-vendbanime pre-historike dhe antike të Ushtelenzes, 11-vendbanim pre-historik të periudhës së bronxit të hershëm (Selanë), 12-Kisha Mesjetare në Katund të Ri, 13-vendbanimi antik dhe mesjetar i Gradecit (Gradec), 14-Vendbanimi i Topojanit, 15-I Tumes së Zojcës (Mazhice), 16-nekropoli i periudhës romake në Gjorice të Poshtme 17-Kalaja Ilire e Tucepit ose Lladomenices etj

5

ne praktike, permbytjen e qendres më të madhe te Shqiptarizmes nder shekuj (vlerat e nje qyteterimi te lashte Ilir) si dhe largimin e mijera dibraneve.

• Ku ne nuk mund te pranojme nje rrenim te dyte qe ky projekt do te shkaktoje, pas ndarjes ne Dibren e Madhe dhe Dibren e Vogel,

• Kemi një detyrim pa dallime politike të jua lëmë trashëgimi brezave trojet e pa permbytura që na i lanë brezat e të parëve tanë duke flijuar jeten në perballje me armiqtë shekullore,

Bazuar ne keto qendime te mbeshtetura, bazuar ne parimet e mire-funksionimin, vet-organizimit dhe

vet-administrimit te pushtetit vendor sipas ligjit dhe

kushtetutes, parimin e vijimesise se lidhjeve shekullore dhe historike te zones dhe

trashëgimise se tyre brezave të ardhshem, dhe parimit te parandalimit te shkakimit te demeve te pa-riparueshme,


Ne, si keshilltare bashkiake, pasi morem parasysh te gjithe informacionin dhe argumentat e deritanishem per kete projekt, vendosem:

-Projekti i Hidrocentralit te Skavices, ka pasoja te pa-riparueshme social mjedisore ne bashkine Diber,

-Ky projekt shkaterron vet funksionimin e bashkise Diber si njesi me vete e pushtetit vendor, duke permbytur shumicen e njesive administrative ne perberje te tij, pa arsye te genesishme, sic kemi konstatuar ne kete rezolute, ne kohen kur ka mundesi alternative, te rekomanduara gjeresisht, per perftimin e energjise elektrike,

-Bazuar ne qendrimin kunder mbarepopullor te banoreve te bashkise Diber, te cilet ne perfaqesojme, duke u bazuar ne trajtimin e ceshtjes jashte politizimit dhe ne gjithepershirje, bejme thirrje qe:

1. Te anulohet projekti aktual i hidrocentralit te Skavices
2. Bashkia Diber te marre persiper rolin kushtetues dhe te kundërshtojë projektin, njejtë sikurse shumica e banoreve,
3. Bashkia dhe Keshilli bashkiak i Bashkise Diber, te mos miratoje akte dhe vendime ne favor te ketij projekti, ne interesin jetik te banoreve te bashkise Diber,
4. Cdo autoritet, publik dhe jo publik, te nderprese qasjen e faktit te kryer, dhe te zbatoje vendimin e gjykates kushtetuese, ne teresi, me komunitetin dhe cdo pale tjeter te interesuar,
5. Te nderpritën prononcime me tone diskriminuese ndaj krahines se Dibres (qe me permbytjen e Dibres do te arrihet qe zona e Nenshkodres te mos permbytet)
6. Te nderpritët qasja diskriminuese per shtepi termeti (me theni publike qe banoret e Dibres do te kene te njejtin trajtim si banoret e prekur nga termeti i vitit 2019) per shkak se banoret jetojne te pa-trazuar ne trojet e tyre shekullore dhe nuk ka ndodhur asnje termet

The bottom of the document features several handwritten signatures in black ink. There are approximately seven distinct signatures, some appearing to be official or formal. The signatures are written in a cursive style and are located below the numbered list of demands.

7. Autoritetet te zbatojne pa vonesa, detyrimet ligjore dhe qendrimet/vendimet e marra per mbrojtjen e floras dhe faunes, per vleresimet e ndikimit social mjedisor etj sipas detyrimeve ligjore ne vend si dhe direktivave perkatese ne organizmat nderkombetare ku Shqiperia aderon,
8. Parlamenti te mos miratoje vendime dhe akte ligjore qe shkojne kunder interesave jetike te banoreve te bashkise Diber, sic u konstatua me ligjin me numer 38/2021, nga gjykata kushtetuese.

Date: 03/05/2024
 Nenshkruar nga:

- | | | |
|-------------------------------------|------------------------|----------------------|
| 1- Marjeta Kica | 12. Hopyraliq | 13. Hoxha |
| 2- Almeta Agolli Agollin | 14. Buzhica | 15. Hoxha |
| 3- Dafina Mudo | 14. Pir | 15. Hysa |
| 4 - Eduina Adem | 15. Dali | 16. Cami |
| 5 - Sara Tomzini | 16. Sokol | Mehdi Sava |
| 6 - Leonida Gjura | | |
| 7 - Ardrit Liqa | | |
| 8 - Adriatik Mndimi | | |
| 9 - Pajtim Jaba | | |
| 10. Pjtrit ALI | | |
| 11 Klaros Belin | | |

